



Seksi i heshtur: Gratë, të përjashtuara nga Opinionet në gazetat gjermane Britania e Madhe, një propozim që mund të dobësojë Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut Kryeministri i Kroacisë hedh poshtë kritikën e BE-së për sa i përket politizimit të kompanive publike

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.9, Maj - Qershor 2012

Speciale

Duke festuar Ditën e Europës!




Ndonëse në ditët e sotme shkëlqimi i dikurshëm i Bashkimit Europian duket se po venitet për shkak të krizës ekonomike dhe politike që ka kapluar këtë të fundit dhe disa prej shteteve themeluese të tij, festimet në kuadër të ditës së Europës nuk kanë reshtur. Që prej vitit 1950, kur Robert Schuman, Ministri i Jashtëm

Francez dhe njëkohësisht një ndër etërit themelues të BE-së mbajti fjalimin e tij historik, 9 Maji festohet në shumicën e vendeve perëndimore Europiane të cilat janë pjesë e kësaj familjeje dhe atyre që aspirojnë të jenë pjesë e saj një ditë. Krahas himnit të BE-së, flamurit dhe monedhës së vetme, 9 Maji përfaqëson një simbol shumë të rëndësishëm për qytetarët e Europës. Në njëfarë mënyre, 9 Maji është kremtimi i paqes dhe unitetit në Europë. Ai është një rast ideal për të kthyer vështrimin mbrapa në histori dhe për të kujtuar atë që e çoi përpara këtë organizatë unike.

...vijon në faqen 2 >>

Ethet e zgjedhjeve në Europë: Francë, Greqi, Serbi, Gjermani, Itali dhe Armeni



Qytetarët votojnë kundër masave të shkurtimeve

Francezët të mërzitur me Merkozy, shikojnë majtas

Në 6 maj francezët zgjodhën socialistin Hollandë karshi presidentit në detyrë Sarkozy. Kjo është hera e dytë që një president nuk konfirmohet për mandatin e dytë, pas d'Estaing. Gjatë fushatës Hollandë ishte shprehur kritik ndaj mënyrës së deritanishme të përbaljes me krizën në nivel BE-je. Shumë analistë e prisnin me hezitim dhe frikë fundin e marrëdhënies Merkozy (Kancelares Gjermane Merkel dhe Presidentit Francez Sarkozy), një hezitim deri diku i pavend, po të kemi parasysh se deri më tani kjo dyshe nuk kishte sjellë rezultate shumë të mira në zgjidhjen e krizës. Me të marrë detyrën më 15 maj, presidenti Hollandë e nisi mandatin me një vizitë në Berlin. Tashmë në BE flitet për Merkolandë – bashkëpunimi Merkel - Hollandë i cili pritet të fokusohet më shumë tek rritja ekonomike sesa masat e ngurta të austeritetit të aplikuara deri më tani.

...vijon në faqen 5 >>

Projekti Europian: Në shpërbërje apo pranë shpëtimit?



Përballë njëra-tjetrës opinionet kontrastuese të tre analistëve të shkëlqyer të Bashkimit Europian: Amartya Sen, Profesor në Harvard dhe fitues i çmimit Nobel për ekonominë, Ivan Krastev, Drejtues i European Council on Foreign Relations, Sofie dhe Dominique Moisi, autor i "Gjeopolitikës së Emocioneve"

Amartya Sen, ekonomisti indian i vlerësuar me çmimin nobel, shtjellon për perstigjozen New York Times dy gabimet themelore në konceptimin dhe zhvillimin e Bashkimit Europian, por gjithashtu edhe rrugëdaljen nga kriza aktuale.

Sipas tij, disa objektiva të denja, por të ngushta të politik-bërësve të Bashkimit Europian kanë qenë të pamjaftueshme për një ekonomi të shëndoshë europiane dhe aktualisht

...vijon në faqen 3 >>



Projekti European: Në shpërbërje apo pranë shpëtimit?

...vijon nga faqja 1 >>

kanë prodhuar kaos, mjerim dhe konfuzion. Ai sheh në veçanti dy arsye. Së pari, synimet mund të jenë të respektueshme pa qenë të qarta dhe themelet e politikës së tanishme të kursimit dhe shkurtimeve, të kombinuara me ngurtësinë e bashkimit monetar të Europës (në mungesë të bashkimit fiskal), nuk mund të quhen një model mendjemprehtë. Së dyti, një qëllim i mirë në vetvete mund të bjerë në konflikt me një përparësi më urgjente - në këtë rast, ruajtja e një Europe demokratike që kërkon të ruajë mirëqenien shoqërore. Këto janë vlera për të cilat Europa ka luftuar gjatë shumë dekadave. Sigurisht, disa vende europiane duhet të tregojnë më shumë përgjegjshmëri ekonomike dhe vendosmëri për të zbatuar rregullat e përbashkëta. Sidoqoftë, faktori kohë është shumë i rëndësishëm, reformat e mirë-menduara dhe në momentin e përshtatshëm dallojnë shumë nga ato të bëra nxitimthi siç është rasti i Greqisë.

Nevoja për reformë nuk ka gjetur përgjigjen e duhur, por ka ndeshur thjesht imponimin e njëanshëm të shkurtimeve të papritura dhe të egra në shërbimet publike. Këto shkurtime në masë, godasin kërkesën - një strategji kjo kundër-produktive, po të marrim parasysh papunësinë e konsiderueshme dhe inaktivitetin e ndërmarrjeve prodhuese që shkatërrohen nga mungesa e kërkesës së tregut. Në fakt, ekzistojnë dëshmi të shumta historike që tregojnë se për të dalë nga kriza, shkurtimi i deficitit duhet kombinuar me investimin për rritjen e shpejtë ekonomike, e cila gjeneron më shumë të ardhura. Deficitet e mëdha pas Luftës së Dytë Botërore në masë të madhe u zhdukën me rritje të shpejtë ekonomike, dhe diçka e ngjashme ka ndodhur gjatë presidencës së Bill Klintonit. Reduktimi i suksesshëm i deficitit buxhetor të Suedisë nga viti 1994 në vitin 1998 ka ndodhur për krah me rritjen e shpejtë. Në kundërshtim me këtë, vendeve europiane sot u kërkohet të shkurtojnë deficitet e tyre duke mbetur të bllokuara në rritje ekonomike të barabartë me zero ose negative.

Por, ndoshta aspekti më shqetësues i situatës në të cilën ndodhet Europa sot është zëvendësimi i angazhimeve demokratike me diktatin financiar - udhëheqësit e Bashkimit European dhe Banka Qendrore Europiane dhe në mënyrë indirekte

me agjencitë vlerësuese, gjykimet e të cilave shpeshherë mund të vihen në diskutim.

Diskutimi publik i hapur dhe pjesëmarrës mund të kishte lejuar identifikimin e reformave të nevojshme, pa kërcënuar themelet e sistemit të Europës të drejtësisë sociale. Por, shkurtimeve drastike në shërbimet publike, me shumë pak diskutim të përgjithshëm mbi nevojën e tyre, efikasitetin ose balancën kanë revoltuar një pjesë të madhe të popullsisë europiane dhe janë përdorur nga ekstremistët në të dy skajet e spektrit politik. Europa nuk mund të ringjallet pa zgjidhur dy aspekte të legjitimitetit politik. Së pari, Europa nuk mund t'ia besojë të ardhmen pikëpamjeve të njëanshme - apo qëllimeve të mira - të ekspertëve pa arsyetime publike dhe pëlqimin e qytetarëve të saj. Rezultatet e zgjedhjeve në disa vende europiane e kanë treguar tashmë pakënaqësinë e qytetarëve. Së dyti, demokracia dhe mundësia e krijimit të politikave të mira minohen kur politika joefektive me të padrejtë diktohet nga udhëheqësit.

New York Times, 22 maj 2012

Shpërbërja e Bashkimit European: Mësime të nxjerra nga kolapsi sovjetik

Studiuesi i mirënjohur Ivan Krastev, na rikujton se në vitin 1992, bota u zgjua dhe zbuloi se Bashkimi Sovjetik nuk ishte më në hartë. Një nga dy superfuqitë e botës kishte rënë pa luftë, pushtim të huaj apo ndonjë katastrofë tjetër. Dhe kjo ndodhi në kundërshtim me të gjitha parashikimet. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik ishte po aq pakonceptueshme për analistët bashkëkohorë sa ç'është perspektiva e shpërbërjes së Bashkimit European sot. Perandoria sovjetike ishte shumë e madhe për të dështuar, shumë e qëndrueshme për tu rrëzuar. Ajo i kishte mbijetuar shumë turbullirave. Por ajo që ishte dikur e paimaginueshme, u bë e pashmangshme. Dhe është pikërisht në lidhje me këtë episod që Bashkimi Sovjetik mund të merret si referencë për diskutimet mbi të ardhmen dhe sfidat e Europës.

Në fund të fundit, kriza aktuale e BE-së ka treguar më së miri se rreziku i shpërbërjes është shumë më tepër se një mjet retorik, një përbindësh lodre i përdorur nga politikanët tek votuesit e pakënaqur për të siguruar zbatimin e masave të kursimit. Ajo është jo vetëm kriza e ekonomive europiane,



Projekti European: Në shpërbërje apo pranë shpëtimit?

...vijon nga faqja 3 >>

por e politikave europiane. Kriza financiare ka reduktuar ndjeshëm jetëgjatësinë e qeverive, pavarësisht nga ngjyra e tyre politike, dhe ka krijuar hapësirë për forcimin e partive populiste dhe protestave. Ndjesia e opinionit publik sot është një kombinim pesimizmi dhe zemërimi.

Kjo reflektohet në sondazhin “e ardhmja e Europës”, financuar nga Komisioni European dhe publikuar në prill të vitit 2012. Sondazhi tregon se ndërsa shumica e europianëve janë dakord se BE-ja është një vend i mirë për të jetuar, besimi i tyre në ecurinë ekonomike të bashkimit dhe aftësinë e tij për të luajtur një rol të madh në politikën botërore ka rënë. Më shumë se gjashtë në dhjetë europianë besojnë që jeta e fëmijëve të sotëm do të jetë më e vështirë se sa ajo e gjeneratës së tyre. Edhe më shqetësuese, pothuajse 90% e europianëve shohin një hendek të madh mes asaj që publiku dëshiron dhe ajo që bëjnë qeveritë. Vetëm një e treta e europianëve mendojnë se vota e tyre ka rëndësi në nivel BE-je.

Në këtë sfond, sa e paimagjinueshme është shpërbërja e BE-së? Këtu, kapaciteti i Europës për të mësuar nga precedenti Sovjetik mund të luajë një rol vendimtar. Sepse mbijetesja e BE-së mund të varet nga aftësia e udhëheqësve të saj për të menaxhuar përzierjen e të njëjtëve faktorë politike, ekonomike dhe psikologjike që ishin në lojë në procesin e shembjes së Bashkimit Sovjetik.

Mësimi i parë që mund të nxirret është njëkohësisht një paradoks: pra, besimi (mbështetur nga ekonomistët, dhe i ndarë nga klasat politike të Europës), që bashkimi nuk mund të shpërbëhet është gjithashtu një nga rreziqet më të mëdha të shpërbërjes.

Perceptimi se shpërbërja është e “paimagjinueshme” mund të provokojë politikë-bërësit të përqafojnë politika apo retorika anti-BE për një periudhë afat-shkurtër, me besimin se “asgjë vërtetë e keqe nuk mund të ndodhë” në planin afatgjatë.

Për më tepër, vlerësimi i rrezikut të shpërbërjes nuk duhet të lihet në dorën e ekonomistëve të cilët shpeshherë janë të verbër, sidomos kur është

fjala për shpërbërje të një sistemi. Të besosh se BE-ja nuk mund të shpërbëhet thjesht sepse ajo është e kushtueshme është një pohim i dobët për stabilitetin e bashkimit.

Mësimi i dytë i rënies së Bashkimit Sovjetik është se reformat e gabuara - edhe më shumë se mungesa e reformave - mund të çojnë drejt shpërbërjes.

Mësimi i tretë i përvojës sovjetike është se rreziku i madh për projektin politik - në mungesë të luftës ose rrethanave të tjera ekstreme - nuk vjen nga destabilizimi në periferi, por nga revolta në qendër (edhe pse kriza në periferi mund të jetë infektuese). Kështu, ishte zgjedhja e Ruisë të hiqte qafe bashkimin, jo dëshira e republikave balltike të largoheshin, shkak që e rrëzoi Bashkimin Sovjetik. Në të njëjtën logjikë, sot, projekti european ndikohet më shumë nga pikëpamja e Gjermanisë se çfarë po ndodh në BE sesa nga problemet e Greqisë ose Spanjës.

Mësimi i katërt është se në qoftë se dinamika e shpërbërjes mbizotëron, rezultati nuk do të ngjajë me një revolucion. Por, faktori më i rëndësishëm që ndikon në shanset e bashkimit për të mbijetuar është besimi i elitave në aftësinë e bashkimit për tu marrë me problemet e tij.

Mësimi i fundit dhe më shqetësues që vjen nga studimi i shembjes së Bashkimit Sovjetik është se në kohë rreziku shpërbërjeje, aktorët politikë duhet të jenë fleksibël dhe të kufizojnë dëshirën e tyre natyrore për ngurtësi dhe zgjidhje afatgjatë (të cilat, kur dështojnë, mund të përshpejtojnë ritmin e shpërbërjes). Fatkeqësisht, aktualisht vendim-marrësit europianë po përpiqen të ruajnë bashkimin nëpërmjet zgjidhjeve politike që kufizojnë thellësisht qeveritë kombëtare dhe zgjedhjet e publikut.

Pritshmëritë janë që politikat e reja të disiplinës fiskale do të ulin presionin politik mbi BE-në. Por, ndërsa ekspertët mund të pajtohen apo jo me të mirat dhe të këqijat e paketave të kursimit, ajo që është më e rëndësishme është se dështimi i tyre automatikisht do të përshpejtojë krizën, dhe kështu do ta bëjë mbijetesën e BE-së më të vështirë. Një dekadë më parë, vendim-marrësit europianë vendosën të mos parashikonin ndonjë mekanizëm

që një vend të linte monedhën e përbashkët në mënyrë që ta bënin ndarjen nga eurozona të pamundur. Është e qartë tani që ky vendim e bën eurozonën më të dobët. Në një mënyrë të ngjashme sovjetikët ndërtuan bashkimin e tyre me idenë për ta bërë atë të pathyeshëm, por ishte kjo ngurtësi e projektit që kontribuoi në shkërmoqjen e tij.

Open Democracy, 15 maj 2012

10 arsye pro Europës!

Dominique Moisi, autori i "Gjeopolitikës së Emocioneve", vë në pah vlerat dhe përparësitë e Bashkimit Europian.

Sipas tij, të bësh rolin e Kasandrës në këto kohë të vështira për Bashkimin Europian është gjëja më e lehtë dhe në dukje më e arsyeshme. Por është pikërisht në këtë moment kritik që është thelbësore të ri-injektojmë shpresë dhe, mbi të gjitha, logjikë në këtë ekuacion.

Ja dhjetë arsye racionale përse është herët të flasim për fundin e BE-së:

Arsyeja e parë për të pasur shpresë është prania në skenën politike e burrave të respektuar të shtetit. Është shumë herët për të parashikuar impaktin e zgjedhjes François Hollande si President i Francës. Por në Itali, një njeri, Mario Monti, tashmë është bërë simbol i ndryshimit. Një arsye e dytë për të besuar në Europë është që me aftësi vjen progresi në qeverisje. Monti dhe Hollandë kanë emëruar të dy gra në pozitat kyçe ministrore. Margjinalizuar për kaq shumë kohë, gratë sjellin oreks për sukses, çka është në avantazh të Europës.

Së treti, opinionimi publik europian e ka kuptuar më në fund plotësisht seriozitetin e krizës. Pa kthjelltësinë e lindur prej dëshpërimit, Monti kurrë nuk do të kishte ardhur në pushtet në Itali.

Arsyeja e katërt për shpresën është e lidhur me krijimtarinë e Europës. Europa nuk është e dënuar të jetë një muze për të kaluarën e vet. Turizmi është i rëndësishëm, sigurisht, dhe nga kjo pikëpamje diversiteti i Europës është një burim unik atraksioni. Por ky diversitet është gjithashtu një burim krijimtari dhe ideshë të reja për zgjidhje. Nga makinat gjermane tek

mallrat luksoze franceze, konkurrenca europiane industriale nuk duhet të nënvlerësohet.

Burimi i pestë i optimizmit është paksa paradoksal. Ekseset nacionaliste kanë qenë të prirura ta çonin Europën drejt luftërave katastrofike. Por kthimi i ndjenjave nacionaliste në Europë sot krijon një ndjenjë rivaliteti dhe konkurrence, i cili ishte i rëndësishëm në rritjen e Azisë para pak vitesh.

Arsyeja e gjashtë është e lidhur me vetë natyrën e sistemit politik të Europës. Europeanët mund të jenë të hutuar, jo shumë eficientë dhe të ngadaltë në marrjen e vendimeve, por demokracia ende përbën një mur stabiliteti kundër pasigurive ekonomike apo pasigurive të tjera.

Arsyeja e shtatë për të besuar tek Europa është e lidhur me universalizmit e mesazhit të saj dhe gjuhës. Pak njerëz ëndërrojnë të bëhen kinezë e të mësojnë gjuhën e komplikuar mandarine. Ndërsa anglishtja, spanjishtja, frëngjishtja dhe gjithnjë e më shumë gjermanishtja po i kapërcejnë kufijtë kombëtarë.

Përtej universalizmit vjen faktori i tetë për të mbështetur mbijetesën e BE-së: multikulturalizmi. Ai është më shumë një burim i fuqisë se e dobësisë. Bashkimi i kulturave në kontinentin e bën njerëzit e tij më të pasur, jo më të varfër.

Arsyeja e nëntë për shpresën buron nga anëtarët e rinj dhe të ardhshëm të BE-së. Polonia, një vend që i takon "Europës së Re" post-komuniste, sikurse dhe një sërë vendesh të Ballkanit po e pasurojnë dhe rrisin legjitimitetin e BE-së. Gjithashtu ato mund të kompensojnë largimin e Greqisë (nëse kjo gjë do të ndodhë).

Së fundi, dhe më e rëndësishme, Europa dhe bota nuk kanë asnjë alternativë më të mirë. Kriza greke mund ta detyrojë Europën të shkojë drejt thellimit të integritetit, me apo pa Greqinë. Filozofi gjerman Jürgen Habermas flet për një realitet "transformues" - një fjalë e ndërlikuar për një realitet të thjeshtë: të ndarë do të biem, ndërsa të bashkuar, edhe pse në mënyrën tonë të ndërlikuar, ne mund të synojmë drejt "madhështisë" në kuptimin e plotë të fjalës.

Project Syndicate, 21 maj 2012



Ethet e zgjedhjeve në Europë: Francë, Greqi, Serbi, Gjermani, Itali dhe Armeni

...vijon nga faqja 1 >>

Është ende herët të flitet për rezultatet e presidentit Hollandë, por vlen të përmendet se ai e mbajti premtimin elektoral për krijimin e një qeverie me numër të barabartë ministrash gra dhe burra.

Zgjedhjet në Greqi ndëshkojnë partitë e mëdha dhe nuk prodhojnë asnjë zgjidhje për vendin

Zgjedhjet parlamentare të 6 majit në Greqi kanë prodhuar një stuhi politike. Asnjë nga tre partitë e mëdha Demokracia e Re (e qendrës së djathtë), SYRIZA (parti e majtë, progresiste liberale) dhe PASOK (e qendrës së majtë) nuk ka arritur të marrë shumicën dhe bisedimet për të formuar një qeveri koalicioni kanë dështuar. Ajo çka bie më shumë në sy është rritja e mbështetjes për partitë e dy ekstremeve, si komunistët e KKE apo neonazistët e Muzgut të Artë. Ky rezultat është interpretuar në shumë vende si një përgjigje e popullit grek kundër masave anti-krizë të aplikuara deri më tani. Në këto kushte, Greqia do të përsërisë zgjedhjet më datë 17 qershor. Sondazhet aktualisht tregojnë në avantazh konservatorët e Demokracisë së Re të cilët janë pro planit të shpëtimit të Bashkimit Europian. Votimet e 17 qershorit në Greqi janë cilësuar si vendimi i qytetarëve për qëndrimin ose daljen nga eurozona.

Një nacionalist për Serbinë

Më 20 maj, Serbia i dha një mandat presidencial Tomisllav Nikoliçit, një nacionalisti, dikur bashkëpunëtor i Sllobodan Milosheviçit. Nikoliç arriti të rrëzonte favoritin e BE-së, pro-europianin Boris Tadic. Në pranverë, me shpresën se do të ndihmonte të moderuarin Tadiç, BE-ja i akordoi Serbisë dhe statusin e vendit kandidat, si shpërblim për marrëveshjet e arritura në bisedimet Beograd – Prishtinë. Ndërkohë që Nikoliç e ka zbutur tonin dhe është shprehur që e ardhmja europiane është e pashmangshme, nuk dihet se cila do të jetë ecuria e marrëdhënies me Kosovën, aq më tepër që edhe marrëveshjet e arritura deri më tani, në realitet nuk po zbatohen. Nikoliç e nisi mandatin e tij me një vizitë në Rusi dhe është shprehur se do të angazhohet për të mbrojtur serbët e Kosovës. Ndërkohë, Serbisë i mbetet ende të krijojë një qeveri, pasi zgjedhjet e 6 majit nuk nxorën fitues të qartë. Në një parlament me 250 anëtarë, Partia Progresiste e Serbisë e Nikoliç

me aleatët, morën 73 vende. Partia Demokratike e Tadiç mori 67 dhe ajo Socialiste e Ivica Daçiç (partia e themeluar nga Sllobodan Milosheviç) mori 44, duke shtuar kështu pretendimet për këtë të fundit të bëhet kryeministër. Por duket se fitorja e Nikoliç ka ndryshuar disi dinamikën dhe Tadiç, i cili në fillim e përjashtoi mundësinë, tashmë mund të behet kryeministër. Kushdo që të qeverisë në Serbi, do të ketë detyrën vështirë të përballjes me 24 për qind papunësi dhe nivel të lartë korrupsioni.

Angela Merkel pëson disfatë të rëndë në një krahinë kyçe të Gjermanisë

Zgjedhjet në Krahinën e Renit Verior – Vestfalisë u dhanë Demokristianëve të Angela Merkel disfatën më të rëndë që prej Luftës së Dytë botërore. Krahina tradicionalisht e djathtë u dha kësaj radhe 39.1 për qind të votave socialdemokratëve, në gjirin e së cilëve është një ngjitje një tjetër politikane grua, Hannelore Kraft. Zgjedhjet e përgjithshme në Gjermani do të mbahen shtatorin e vitit që vjen. Ky votim duket një reagim mospëlqimi ndaj masave të kursimit të vendosura nga Merkel deri më sot si rrugëdalje nga kriza dhe sigurisht ai do ta ulë popullaritetin dhe autoritetin e Merkelit në Bruksel për të vazhduar me këto masa.

Ky rezultat vjen vetëm pak ditë pasi francezët zgjodhën për president socialistin Francois Hollande, i cili gjatë gjithë fushatës e kishte kritikuar qasjen gjermane ndaj krizës e cila parashikonte vetëm kursime dhe shkurtime. Po në të njëjtën periudhë, zgjedhësit grekë votuan kryesisht parti nacionaliste anti-kursim dhe shkurtime.

Po në 6 maj, në **Itali** u mbajtën zgjedhjet lokale. Kryesisht ato nxorën në pah pakënaqësinë me partitë politike kryesore të qendrës së majtë apo djathtë, duke treguar kështu dhe pakënaqësinë me masat e rrepta të qeverisë teknike Monti pasi kjo e fundit mbështetet nga të tre partitë më të mëdha në Itali.

Edhe **Armenia** ka mbajtur zgjedhje të përgjithshme në 6 maj. Ato u cilësuan përgjithësisht si të rregullta nga perëndimorët, por janë kontestuar nga aktorë të ndryshëm të brendshëm. Zgjedhjet rikonfirmuan në pushtet Partinë Konservatore.

Stafi i EuroSpeak, maj 2012



Kartolina nga BE-ja

Ministrat e BE-së hedhin idenë e krijimit të një “super presidenti”



Foto: bbc.co.uk

Kohët e fundit në Bruksel qarkullon ideja e krijimit të një grupi reflektimi të përbërë nga ministrat e jashtëm të BE-së me qëllim shqyrtimin e mundësisë për të shkruar në një të vetëm rolet e Presidentit të Këshillit të BE-së dhe atij të Komisionit Europian. Sipas këtij plani, ky “super president” do të ketë më shumë pushtet se Van Rompuy dhe Manuel Barroso sot, por edhe më shumë legjitimitet demokratik, pasi ai do të zgjidhet nga eurodeputetët. Çdo vend i BE-së do të vazhdojë të ketë komisionerin e vet me votën e tyre në kolegjin e 27 zyrtarëve më të lartë. Por disa komisionerë do të kenë më shumë se një dosje, ndërsa të tjerët do të jenë ekuivalenti i ministrave pa portofol.

Super-presidenti i ri mendohet se do të drejtojë gjithashtu Këshillin për Çështjet e Përgjithshme takimet mujore të ministrave të jashtëm që të diskutuar çështjet e brendshme të Bashkimit Europian.

Presidenti i Këshillit të BE-së është një figurë e krijuar nga Traktati i Lisbonës në vitin 2009.

Grupi i reflektimit lindi me nismën e Ministrat të Jashtëm Gjerman Westerwelle në muajin mars. Ai do të mblihet dy herë para pushimeve të verës dhe do të qarkullojë një projekt-ide për diskutim në nivel BE-je në shtator.

Vendet e tjera të grupit të reflektimit janë: Austria, Belgjika, Danimarka, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Portugalia dhe Spanja.

EU Observer, 20 prill 2012

Seksi i heshtur: Gratë, të përjashtuara nga Opinonet në gazetat gjermane

Gazetat gjermane janë plot komente e opinione të thella dhe të mirë-artikuluara. Por, një vlerësim i kohëve të fundit tregon se editorialet janë pothuajse gjithmonë të shkruara nga burrat. Ndërkohë që debati mbi kuotat gjinore

është në qendër të vëmendjes, gjysma e popullsisë, gratë janë të përjashtuara nga kjo platformë ndikimi në opinionin publik.

Edhe pse ka shumë prezantuese televizive të suksesshme, gjendja e gazetarisë së shtypit, megjithatë, është shumë më pak premtuese. Në median e shkruar gazetaret gra rrallë herë mbulojnë role drejtuese. Lidhur me këtë çështje, në shkurt 350 gazetarë gra u drejtuan një letër të hapur redaktorëve dhe shefave të gazetave kryesore. Në pothuajse të gjitha gazetat kombëtare, kryeredaktorët janë meshkuj, dhe ata të vendosin se çfarë do të publikohet në gazeta. Por kush shkruan përmbajtjen e gazetës? Kështu, një monitorim eksperimental i Spiegel Online ka studiuar gjininë e editorialistëve në tetë gazeta kryesore gjermane për më shumë se tre javë, nga fundi i shkurtit deri në mes të marsit. Rezultati? Gratë kanë një pjesëmarrje marginale. Vetëm rreth 18 përqind e të gjitha editorialeve janë shkruar nga gra. Studiuesit e gazetave kanë kohë që kanë zbuluar se për gratë tema nuk është faktori vendimtar në artikujt që ato zgjedhin të lexojnë. Në fakt, gratë lexojnë çdo gjë, edhe faqet sportive. Por ajo që është e rëndësishme për to është trajtimi që i bëhet një teme dhe kjo ka të bëjë me shpjegimin e mirë të kontekstit, si dhe stilin e të shkruarit. Jo vetëm numrat janë të rëndësishëm, por edhe kuptimin e tyre. Jo vetëm citatet, por edhe konteksti i tyre. Jo vetëm teoritë, por dhe antitezat.



Foto: www.guardian.co.uk

Përqindja e grave në redaksi është shumë më e madhe se në nivele drejtuese. Kryeredaktorët po përpiqen të nxisin gratë të dalin nga qoshet e pluhurosura të redaksive dhe të marrin drejtimin e gazetave. Editorialet janë pjesë kryesore të medias së shkruar, dhe gratë duhet të jetë atje! Ky është një apel për gratë që dëshirojnë të shkruajnë dhe eprorët e tyre.

Përqindja e grave në redaksi është shumë më e madhe se në nivele drejtuese. Kryeredaktorët po përpiqen të nxisin gratë të dalin nga qoshet e pluhurosura të redaksive dhe të marrin drejtimin e gazetave. Editorialet janë pjesë kryesore të medias së shkruar, dhe gratë duhet të jetë atje! Ky është një apel për gratë që dëshirojnë të shkruajnë dhe eprorët e tyre.

Komunikimi i burrave është shpesh më i qartë, sepse stili më lakonik lë pak hapësirë për vetë-dyshim. Gratë rregullisht bien në



grackën e të justifikuarit të vetes. Shkrimtarët meshkuj shpesh shprehin një këndvështrim sikur ata të ishin mbretër në tokë dhe të përfaqësonin pikëpamjen e shumicës. Shkrimtarët gra argumentojnë, peshojnë, mendojnë me zë të lartë dhe në fund akuzohen që nuk kanë asnjë opinion vetjak. Përndryshe, përse do nevojiteshin kaq shumë fjalë?

Në qoftë se kryeredaktorët ankohen se nuk arrijnë të gjejnë kolege të gatshme dhe të afta gra që të shkruajnë editoriale, duhet të marrin parasysh faktin që ndoshta kjo ndodh sepse kërkojnë njerëz që arsyetojnë në mënyrë të njëjtë me ta.

Spiegel Online, 4 prill 2012

Britania e Madhe, një propozim që mund të dobësojë Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut



Foto: halsburyslawexchange.co.uk

Prej disa kohësh po zhvillohet një debat mbi reformimin e Gjykatës së Strasburgut. Sipas Diogo Pintos, Sekretar i Përgjithshëm i Lëvizjes Europiane Ndërkombëtare me qendër në Bruksel “iniciativa më e re e qeverisë britanike mund të dobësojë Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke vënë në rrezik kështu të drejtat e njeriut në Europë”. Kjo pasi në praktikë, propozimi britanik synon t’u japë fuqi gjykatave kombëtare të vendosin se cilat raste duhet të shqyrtohen nga Gjykata Europiane dhe qeverive kombëtare si dhe liri më të madhe veprimi në zbatimin e vendimeve të saj. Ndërkohë, po lindin shqetësime pasi kjo do të shkelte të drejtën e individëve në të gjithë Europën për të aplikuar në Gjykatë.

Pinto sqaron se “projekt-propozimi i Mbretërisë së Bashkuar parashikon dhe një ndryshim të “marzhit të vlerësimit” të Gjykatës - një koncept që mundëson që ajo të aplikojë dokumentin e saj themelues, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, ndryshe për secilin shtet anëtar, duke zgjeruar kështu kompetencat kombëtare mbi gjykatën dhe duke e bërë atë jomë shumë një organ këshillimor.” Mbretëria e Bashkuar është gjithashtu të prirur të bëjë më strikt kriterin e pranueshmërisë,

duke e bërë të vështirë për individët të çojnë rastet në gjykatë. Ndërkohë, ministra dhe përfaqësues të lartë të Këshillit të Europës (KE) po e shqyrtojnë propozimin.

Britania e Madhe, e cila mban aktualisht presidencën e KE-së, ka pohuar se GJEDN po dëmton përpjekjet kombëtare për të ndryshuar politikën e imigracionit, deportimin e terroristëve dhe përcaktimin e rregullave për të burgosurit.

Nga ana tjetër, GJEDN është rekursi i fundit për viktimat e abuzimeve të të drejtave të njeriut të cilët mund të paraqesin ankesat vetëm pas rrëzimit të të gjitha ankesave të tyre në nivel kombëtar.

EU Observer, 19 prill 2012

Talin, kryeqyteti i parë në Europë që ofron transport publik falas

Muajin e kaluar, nëpërmjet një referendumi 75 për qind e qytetarëve të Estonisë votuan pro idesë për të pasur transport me autobus dhe tren falas. Kështu Talini, kryeqyteti i Estonisë do të jetë i pari kryeqytet europian me transport publik falas. Mbështetësit e kësaj iniciative thonë se kjo do të ndihmojë në uljen e ndotjes së ambientit, por në fakt ajo po ndesh shumë kundërshtarë. Kritika e parë e ngritur ka të bëjë me faktin se nëse ofrohet diçka falas, sigurisht që të gjithë do të votojnë pro, ama kjo pa i marrë në konsideratë pasojat afatgjata të këtij përfitimi.

Për ironi, transporti publik falas kundërshtohet edhe nga Partia e Gjelbër e Estonisë. Sipas të gjelbërve, kalimi nga subvencionimi prej 70 për qind tek mbulimi i të gjithë faturës së transportit nga ana e shtetit do të ulë mundësitë për investime. Kjo do të bëjë që në planin afatgjatë, transporti hekurudhor dhe ai me autobus të gëzojë cilësi edhe më të ulët, duke i shtyrë sërish qytetarët që të përdorin gjerësisht makinat private.

Ndërkohë që efektet reale mbi ambientin do të shihen në disa vite, aktualisht qytetarët po i gëzohen transporti publik falas.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2012

Në pritje të aderimit...

Islanda nën presionin e ndalimit të procesit të anëtarësimit në BE

Sipas medias vendase në Islandë, Komisioni European po përpiqet të përfshihet në procedurat ligjore të nisura nga Autoriteti i Mbikqyrjes së EFTA-s (ESA) kundër Islandës për shkak të mosmarrëveshjes me Britaninë e Madhe dhe Hollandën mbi çështjen e "Icesave". EFTA, Zona Europiane e Tregtisë së Lirë, është kuadri kryesor i marrëdhënieve midis Islandës dhe BE-së. Mediat islandeze raportuan se kjo është hera e parë që Komisionit European do t'i jepet e drejta e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në një çështje para Gjykatës së EFTA-s.

Ky veprim ka shkaktuar reagime të ashpra mes politikanëve islandezë, duke sjellë si rrjedhojë rritjen e presionit politik në parlamentin e vendit për të ndaluar bisedimet e pranimit në BE.

Sipas diplomatëve të BE-së, pavarësisht komenteve të shtypit islandez, Komisioni nuk po merr anën e Britanisë, Hollandës apo dikujt tjetër kundër Islandës. Çështja aktuale përpara Gjykatës së EFTA-s nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me aplikimin e Islandës për anëtarësim në BE, por ka të bëjë me një proces të veçantë ligjor.

EurActiv, prill 2012

Vazhdon të përshkallëzohet tensioni etnik në Maqedoni



Tensioni i fundit etnik nisi më 13 prill me zbulimin e pesë peshkatarëve maqedonas të vrarë pranë një liqeni në fshatin Smiljkovci, në veri të Shkupit.

Autoritetet nuk kanë dhënë ende një arsye për vrasjet, por spekulimet rreth ekzekutimeve kriminale janë fokusuar në tensionet më shqiptarët etnik. Ndërkohë që Presidenti Maqedonas Gjorge Ivanov ka bërë thirrje për qetësi dhe përshpejtim të hetimeve, udhëheqësit politikë të shqiptarëve etnikë u kërkojnë qytetarëve dhe medias të përmbahen nga spekulimet. Mes tyre është edhe ish-udhëheqësi rebel Ali Ahmeti, i cili tani është president i partisë më të madhe etnike shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integrim, e cila është në koalicion me VMRO-DPMNE të kryeministrit Nikola Gruevski.

Në vizitën e tij në Shkup, Kryeministri çek, Petr Nečas, paralajmëroi se tensioni etnik në Maqedoni mund të dëmtojë përpjekjet integruese të vendit. Nga ana tjetër, Komisioneri për Zgjerimin, Stefan Fule, ka deklaruar se Komisioni nuk ka informata se vrasja e peshkatarëve ka origjinë etnike.

Pas arrestimesh të shumta dhe lëshimesh për mungesë provash, situata vazhdon të jetë tejet e brishtë duke lënë hapësirë për spekulime të mëtejshme, çka përkeqëson dhe përshkallëzon akoma më shumë gjendjen e rënduar të bashkëjetesës së etnive në Maqedoni.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2012

A ka funksionuar taksa e sheshtë në vendet e Ballkanit Perëndimor?

Gjatë dekadës së fundit, taksa e sheshtë është aplikuar në shumicën e vendeve të rajonit. Bosnja dhe Hercegovina futi e para normën më konkurruese prej 10 për qind në vitin 2004 dhe më pas u ndoq nga Shqipëria në vitin 2007 dhe Bullgaria në vitin 2008. Rumania ka aplikuar taksën e sheshtë më të lartë prej 16 për qind në vitin 2005, e pasuar nga Mali i Zi me po të njëjtën taksë në vitin 2007. Serbia ka pasur një normë 14% të taksës së sheshtë që nga viti 2003.

Shpresa e qeverive të këtyre vendeve ka qenë që taksa do të nxiste investimet e huaja direkte dhe do të ndihmonte rritjen ekonomike. Efektet e saj tek konsumatorët dhe bizneset mbeten një pikë e nxehtë debati në Shqipëri dhe vende të tjera. Ndërkohë Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka publikuar një raport që hedh dritë mbi nivelin e investimeve të huaja direkte në rajon gjatë viteve të fundit. Ai sugjeron se deri më tani, taksa e sheshtë nuk ka sjellë efektet e dëshiruara. Në fakt, sipas Bankës Botërore dhe BERZH-it investimet e huaja direkte kane rënë në të gjithë rajonin.

Në Shqipëri, Bosnje dhe Herzegovinë, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbia, këto investime aktualisht janë 60 për qind më të pakta se para 2007-ës.

SETimes, 15 maj 2012



Turqia: Një ekonomi për të cilën duhet të shqetësohemi



Gjatë dekadës së fundit, Turqia ka gëzuar një rritje ekonomike spektakolare, ndjekur nga një huamarrje e huaj po aq spektakolare. Vitin e kaluar Turqia pati një rritje ekonomike prej 8.5 për qind e nxitur kryesisht nga krediti, i cili në një moment po futej në vend me një ritëm vjetor prej më shumë se 40 për qind. Të huajt huazuan pjesën më të madhe të parave. Defiçiti i bilancit tregtar të Turqisë tejkaloi 10 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), dy herë më shumë se shumica e tregjeve në zhvillim.

Kjo rritje e përshpejtuar u ngadalsua ndjeshëm në fund të vitit të kaluar, pasi për shkak të ankthit të investitorëve dhe rënies së ndjeshme të Lirës banka qendrore u detyrua të shtrëngojë politikën monetare. PBB u ngadalësua dhe arriti vlerën e 5.2 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2011. Edhe pse vendi vazhdon të ketë rritje të ngadaltë, inflacioni mbetet mbi 10 për qind dhe defiçiti i bilancit tregtar mendohet të qëndrojë rreth 8 për qind të PBB. Duke pasur pak investime të huaja direkte, pjesa më e madhe e defiçitit do të duhet të financohet nga obligacionet dhe bankat.

Aktualisht, të huajt nuk duken shumë të shqetësuar. Lira është forcuar dhe bursa e Stambollit është rritur më 20 për qind që nga fillimi i vitit. Por ringjallja e dukshme e hyrjeve të kapitalit ndoshta ka të bëjë më shumë me pasurimin e tregut me likuditet nga bankat qendrore, sidomos sigurimi masiv nga Banka Qendrore Europiane, se sa me konfidencën që rrezaton ekonomia turke. Ky kurs i ekonomisë ecën paralelisht me shqetësimin e gjerë për një kolaps të mundshëm.

The Economist, prill 2012

Kryeministri i Kroacisë hedh poshtë kritikën e BE-së për sa i përket politizimit të kompanive publike



Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së ka miratuar më 24 prill konkluzionet e një raporti të Gjykatës së Auditorëve të BE-së (EUCA) mbi kapacitetin e Kroacisë për të menaxhuar fondet e pas-anëtarësimit. Sipas EUCA, rezultatet e asistencës para-anëtarësimit kanë qenë pjesërisht të suksesshme dhe se zbatimi i asistencës ishte vonuar. Sipas raportit, përqëndrimi në zhvillimin e projekteve madhore të infrastrukturës ka qenë në dëm të zhvillimit të projekteve të tjera, sidomos atyre të nivelit lokal dhe rajonal.

Gjykata gjithashtu thekson se hapa të rëndësishëm janë marrë për të forcuar strukturat e anti-korrupsionit gjatë mandatit të qeverisë së mëparshme. Megjithatë, sipas raportit të Komisionit, "hapat e para të marra nga qeveria e re në lidhje me rregullat e konfliktit të interesit janë shqetësuese", duke theksuar se "dispozitat e mëparshme të kriterëve të anëtarësimit janë përmbysur" (lidhur me bordet mbikëqyrëse dhe menaxhimin e kompanive publike). Komisioni i bën thirrje Kroacisë të sigurojë një sistem të fortë për parandalimin e korrupsionit në kompanitë shtetërore dhe në llogaridhënien politike.

Kryeministri i Kroacisë, Zoran Milanović, e hodhi poshtë këtë vërejtje të Komisionit. Sipas tij kjo vërejtje është "pak e çuditshme", pasi kjo çështje e veçantë nuk ka të bëjë fare me *acquis-në* dhe se disa shtete anëtare të BE-së kanë rregulla të tilla.

Raporti i Komisionit i ka kushtuar vëmendje të veçantë legjislacionit të ri të propozuar për privatizimin e kompanisë kombëtare petrokimike INA, dhe telekomit kombëtar. Dy nga pjestarët e emëruar të bordit drejtues të INA-s janë pikërisht Radimir Čačić (udhëheqësi i liberalës HNS, partner koalicioni për qeverinë) dhe Slavko Linić (një ndër aktorët kryesorë të social-demokratëve, partisë në pushtet).

INA është një kompani publike mjaft fitimprurëse dhe pozicioni i anëtarit të bordit është mjaft i



dëshirueshëm. Zëvendës kryeministri Çaçiq dhe Ministri i Financave Liniç, janë dy politikanë që kryeministri duhet t'i mbajë të kënaqur në mënyrë që të jetë në gjendje të qeverisë. Emërimi i tyre në bordin e INA-s me siguri mund t'i shërbejë këtij qëllimi, por cili do të jetë çmimi që duhet të paguajë Kroacia për këtë?

NewEurope, prill 2012



Para në dorë

Pavarësisht peripeçive aktuale, Euroja është valuta më e ollshme në botë për sa i takon kartëmone-dhave dhe monedhave të saj në qarkullim. Ajo ndiqet pas Jenit japonez dhe Dollarit amerikan.

Economist, Graphic detail, 2 prill 2012

Bie mbështetja për BE-në, por jo për Euron!

Sipas një sondazhi të fundit të Pew Centre, një qendër kërkimesh në Uashington, një numër në rritje qytetarësh në Britani, Francë, Spanjë, Itali, Republikën Çeke, Poloni dhe Greqithonë se integrimi ka dobësuar ekonominë e tyre dhe kanë dyshime nëse anëtarësimi në Bashkimin Europian është një gjë e mirë. Vetëm në Gjermani, ekonomia më e madhe Europës dhe kontribuesi më i madh në programet e ndihmës së vendeve në krizë, entuziazmi për BE-në është rritur që nga viti 2009. Gjashtëdhjetë e pesë për qind e gjermanëve e shohin anëtarësimin në një dritë pozitive.

Megjithatë, edhe pse 54% e spanjollëve vënë në dyshim vlerën e të qenit në Bashkimin Europian, rënia e mbështetjes nuk përkthehet në thirrje për të dalë zona e euros. Në fakt, 60 për qind e spanjollëve ende e mbështesin monedhën e përbashkët. Akoma më interesant është fakti se në Greqi, përtej të gjitha debateve të ditëve të fundit, vetëm 23 për qind e popullsisë dëshirojnë të kthehen tek dhrahmia. Ironia këtu është se njerëzit të cilët kanë euron ende duan ta mbajtur atë. Megjithë vështirësitë që po kalojnë disa vende, qytetarët e kuptojnë se

rikthimi tek valutat e vjetra do të ishte një hap i gabuar dhe shumë i kushtueshëm. Dëshira për të dalë nga eurozona është më e fortë në Itali, ku 40 për qind e të anketuarve pohojnë se do të dëshironin t'i ktheheshin lirës, por gjithsesi shumica mbetet në favor të monedhës së përbashkët.

EurActiv, 30 maj 2012

Eurozona kryesohet gjithnjë e më shumë nga Gjermania

Më 15 maj Komisioni Europian publikoi të dhëna mbi produktin e brendshëm bruto të vendeve anëtare.

Të dhënat janë pak më të mira sesa pritej për disa vende, e sidomos për sa i takon Gjermanisë. Ekonomia e këtij vendi i ka tejkaluar pritshmëritë duke u rritur me 0.5 për qind gjatë tre muajve të parë të vitit. Në tërësi, Eurozona regjistron rritje shumë modeste, madje pa Gjermaninë ekonomia e saj do të kishte rënë me 0,2 për qind. Gjermania përbën rreth 28 për qind të produktit të euro-zonës, por kontributi i saj në eurozonë është rritur ndjeshëm nga viti 2004. Ajo ishte përgjegjëse për 65 për qind të rritjes së rajonit në prodhim mesatarisht që nga viti 2007. Ndërkohë vende periferike zonën e euros si, Irlanda, Italia, Greqia dhe Spanja shënojnë rënie nga një mesatare para krizës prej 45 për qind, në një minimum prej 10 për qind nga viti 2007.

Economist, Graphic detail, 2 prill 2012

Cila është vlera e një medalje të artë olimpike?

Medaljet e arta që do të jepen në Londër këtë vit do të jenë më të mëdhatë e të rëndat e shpërndara ndonjëherë në Olimpiadia. Me një peshë prej 400 gramësh ato do të jenë 17 herë më të rënda se ato të shpërndara në Olimpiadën e vitit 1912 në Stokholm. Nga ana tjetër, medaljet që shpërndaheshin dikur përbëheshin tërësisht prej ari. Tani ato përbëhen kryesisht prej argjendi me një shtresë të hollë ari -6 gram. Medalja në Londër do të ketë një përbajtje ari rreth 1.5 për qind, dhe çmimi real është afërsisht 706 dollarë.

Economist, Graphic detail, 5 prill 2012



Londra, qyteti i gjashtë më i madh i Francës

Në Londër jetojnë më shumë francezë se në Bordo, Nantes apo Strasburg duke bërë kështu që ajo të konsiderohet si qyteti i gjashtë më i madh i Francës për sa i përket popullsisë.

Sot, francezët gjenden në çdo cep të Londrës dhe numrat e tyre po rriten. Kjo ka rezultuar që ata, bashkë me të imigruarit në Skandinavi, të votojnë në zgjedhjet parlamentare të Francës javën e ardhshme për një kandidat që do t'i përfaqësojë në Asamblenë Kombëtare.

Sipas konsullatës franceze në Londër, qytetarët francezë që jetojnë në kryeqytetin britanik llogariten të jenë midis 300.000 dhe 400.000, ku shumë prej tyre jetojnë në East End. Marine Schepens, e cila punon në një agjenci reklamash, thotë se kompanitë angleze janë më të gatshme t'i japin një shans të rinjve se sa ato franceze. Kjo për shkak të lehtësive që ekzistojnë në mbylljen e kontratave të tyre. Ky fleksibilitet i bën punëdhënësit më të hapur me punësimin e të rinjve. "Unë ndryshova karrierë një vit më parë. Nëse do isha në Francë do ndjehesha me fat që kisha atë punë dhe nuk do ta lëshoja kurrë", thotë ajo.

Nadege Alezine, një gazetare nga Bordo, thotë se jeta në Londër nuk është për njerëzit pa ambicie. Ajo drejton një faqe interneti për komunitetin francez të quajtur bealondoner.com. "Nëse doni siguri dhe pushime të këndshme atëherë qëndroni në Francë. Nëse kërkonit aventurë dhe doni të përvetësoni aftësi të reja, hajdeni këtu", thotë ajo.

BBC, 30 maj 2012

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shqipëri, Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit Europian.



British Embassy
Tirana



FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



Europe for Citizens
Programme

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Ndonëse pranohet gjerësisht se integrimi në BE është një prioritet kombëtar, opinioni publik ende mbetet përgjithësisht i painformuar. Kjo situatë shqetësuese mund të shpjegohet jo vetëm nga kompleksiteti i procesit, por edhe nga fakti që shpesh informacioni dhe analiza mbi BE-në nuk ofrohet nga ekspertët, por jepet kryesisht nga politika. Për të nxitur një debat sa më të informuar mbi stadin e reformave të integritit në Shqipëri, EMA po zbaton projektin "Shtjellimi i Procesit të Integritit Europian", mbështetur nga Ambasada Britanike në Shqipëri.

Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në sitin e Lëvizjes Europiane në Shqipëri.

Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren,

Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org